

L I G J

Nr.7651, datë 21.12.1992

I azhurnuar me:

Ligjin Nr.7770, datë 22.11.1993

Ligjin Nr.7780, datë 22.12.1993

Ligjin Nr.8065, datë 08.02.1996

Ligjin Nr.8214, datë 07.05.1997

Ligjin Nr.8253, datë 30.10.1997

Ligjin Nr.9137, datë 25.09.2003

Ligjin Nr.9222, datë 15.04.2004

”PËR FESTAT ZYRTARE E DITËT PËRKUJTIMORE”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

Neni 1

Janë ditë pushimi ditët e këtyre festave zyrtare:

- a) 1 dhe 2 janari - Viti i Ri.
- b) 1 Maji, dita ndërkombëtare e punonjësve.
- b/1) 19 Tetori - Dita e Lumturimit të Nënë Terezës
- c) 28 Nëntori dita e Flamurit dhe e Pavarësisë është ditë e festës kombëtare.
- c/1) 29 Nëntori dita e Çlirimit të Shqipërisë nga pushtuesit nazifashistë.
- ç) Bajrami i Madh, dita e parë.
- d) Bajrami i Vogël, dita e parë.
- dh) Pashkët Ortodokse, dita e parë.
- e) Pashkët Katolike, dita e parë.
- ë) Krishtlindjet, dita e parë.
- f) 22 marsi, Dita e Nevruzit.
- g) 14 Marsi - Dita e Verës.

Kur ditët e festave zyrtare të mësipërme bien ditën e shtunë ose të dielë, ditë pushimi do të jenë ditët pasardhëse të punës.

Neni 2

Pranë Këshillit të Ministrave të ngrihet një komision për t'i propozuar parlamentit katalogun e plotë të festave zyrtare dhe jo zyrtare.

Neni 3

Dekreti nr.1600, datë 8.1.1953 "Për festat zyrtare", si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shhfuzohen.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.401, datë 23.12.1992, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.